



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta  
/ Ministry of Culture, Youth and Sport

---

Prishtinë, 15 Mars 2023

## THIRRJA PËR FONDIN E MOBILITETIT 2023

SPORT - RINI - ART - TRASHËGIMI KULTURORE

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2023 synon promovimin dhe fuqizimin nëpërmjet prezentimit ndërkombëtar të sportit, rinisë, artit dhe trashëgimisë kulturore.

Me qëllim të zhvillimit të diplomacisë publike, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në thirrjen për Fondin e Mobilitetit 2023 parasheh të mbështesë individët dhe OJQ-të në kategoritë si në vijim:

- **Kategoria e Sportit** (pjesëmarrje e sportistëve në aktivitete ndërkombëtare, prezentimi i talentit dhe kapaciteteve profesionale në arenën ndërkombëtare);
- **Kategoria e Rinisë** (pjesëmarrje e të rinjve në aktivitetet ndërkombëtare);
- **Kategoria e Artit dhe Trashëgimisë Kulturore** (promovimi ndërkombëtar i produktit kulturor vendor dhe i skenës së pavarur).

OJQ-të, anëtarët e OJQ-ve dhe individët tjerë, mund të aplikojnë **vetëm në njërin nga tre kategoritë** e kësaj thirrjeje publike.

Tre kategoritë e listuara më sipër janë elaboruar më poshtë, duke zbërthyer synimet dhe aktivitetet përkatëse, fushëveprimin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikantin, si dhe shkallën maksimale dhe minimale të mbështetjes.

## SPORT

### Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të sportit të Kosovës dhe zhvillimit të sportit vendor përmes pjesëmarrjes në aktivitete sportive ndërkombëtar

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon promovimin dhe prezantimin ndërkombëtar të sportit vendor, dhe zhvillimin e tij përmes pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare.

Krahas promovimit të sportit vendor, synohet edhe prezantimi i talentit dhe kapaciteteve profesionale nga fusha e sportit në arenën ndërkombëtare duke kontribuar në zhvillimin e diplomacisë publike.

Në këtë kategori të thirrjes publike parashihet mbështetja e nismave individuale dhe grupore, për:

- Pjesëmarrje në aktivitete të cilat kontribuojnë në promovimin ndërkombëtar të sportit vendor dhe zhvillimin e tij përmes pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare,
- Aktivitetet të cilat mund të mbështeten përmes këtij fondi janë pjesëmarrja dhe prezantimi i individëve dhe OJQ-ve në ngjarje ndërkombëtare sportive duke përfshirë: garat, kampet stërvitore, konferencat, seminarët, festivalet, panairët, etj.

Nëpërmjet kësaj thirrjeje publike, individët dhe OJQ-të mund të mbështeten për mbulimin e shpenzimeve sikurse: shpenzime të udhëtimit, shërbime të transportit, akomodimi, shpenzimi i vizave, regjistrimi për pjesëmarrje në platformat respektive, mëditje, pagesë (taksë), etj.

#### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe klubet dhe shoqatat sportive të profilizuara dhe me përvojë të dëshmuar në fushën e sportit, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- Individët që janë shtetas të Republikës së Kosovës, të profilizuar dhe me përvojë të dëshmuar në fushën e sportit, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kjo thirrje publike nuk parasheh mbështetjen financiare të projekt-propozimeve të Federatave Sportive të Kosovës, rrjedhimisht aktiviteteve të klubeve apo individëve që zhvillohen në kuadër të reprezentacioneve sportive të Kosovës.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

**Vlerësimi i projekt-propozimeve** do të zhvillohet në dy faza:

**Vlerësimi administrativ**, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

**Vlerësimi përmbajtësor:**

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e sportit;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit (nëse aplikohet);
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike, karshi çmimeve të tregut, dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

**Aplikimi**

Aplikimi me projekt-propozime bëhet përmes e-mail-it: [mobiliteti.mkrs@rks-gov.net](mailto:mobiliteti.mkrs@rks-gov.net)

**Dokumentet e nevojshme**

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/program,
2. Formulari i Propozim buxhetit,

3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
4. Formular i deklaratës se partneritetit,
5. Forma e deklaratës se projekteve të financuara,
6. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal,
7. Dokumentacioni për bartësin e projektit dhe individët/profesionistët e angazhuar: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale;

#### **Afati për aplikim:**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën **07 Prill 2023**.

#### **Më shumë informacione rreth thirrjes publike:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [adelina.dreshaj@rks-gov.net](mailto:adelina.dreshaj@rks-gov.net).

#### **Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2022;
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike;
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

**Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara dhe me përvojë të dëshmuar në sektorin e sportit (*të cilat nuk janë klube apo shoqata sportive por që fushëveprimtari të tyre kanë fushën e sportit*) që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Klubet apo shoqatat sportive duhet të dëshmojnë regjistrimin e tyre në Departamentet e Sportit të komunave përkatëse ku zhvillojnë aktivitetet;
- Klubet apo shoqatat sportive duhet të dëshmojnë anëtarësinë e tyre në federatat sportive përkatëse të licencuara në MKRS, apo që janë në procesin e licencimit të cilat potencialisht mund të licencohen deri në mbylljen e procedurave të komisioneve vlerësuese;
- Aplikuesit të cilët aplikojnë duhet të dëshmojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet ndërkombëtare (gara, kampe, semirane, konferenca, etj) përmes thirrjeve apo ftesave për pjesëmarrje apo/ose letër konfirmimit për pranim apo regjistrim për pjesëmarrje në aktivitetin përkatës.
- 

**Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Individit duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2022 (*përfshihen përfituesit në thirrjen e vitit 2023 të Fondit për Shërimin dhe Rikuperimin e Lëndimeve Sportive*).
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se një projekt-propozim në këtë thirrje publike;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

**Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Profilet e përshtatshme të individëve për këtë thirrje janë sportistët, trajnerët apo instruktorët sportiv, referët/gjyqtarët sportiv, studiues hulumtues në fushën e sportit, apo profesionistë të profileve të ndryshme në fushën e sportit, etj;
- Individët, me theks të veçantë sportistët, trajnerët dhe referët/gjyqtarët, nuk mund të aplikojnë për aktivitete të cilat zhvillohen në kuadër të programit të reprezentacionit, për të cilat kanë pranuar mbështetje financiare nga federatat sportive përkatëse.
- Aplikuesit të cilët aplikojnë duhet të dëshmojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet ndërkombëtare (gara, kampe, semirane, konferenca, etj) përmes thirrjeve apo ftesave për pjesëmarrje apo/ose letër konfirmimit për pranim apo regjistrim për pjesëmarrje në aktivitetin përkatës.

## Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2023.

## Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues N.A. Euro

## RINIA

### Fondi i mobilitetit për fuqizim të të rinjve përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon promovimin dhe fuqizimin e rinisë së Republikës së Kosovës përmes pjesëmarrjes së tyre në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare.

Në këtë kategori të thirrjes publike parashihet mbështetja e nismave individuale dhe grupore, për:

- Pjesëmarrje, prezantim apo performim i të rinjve dhe OJQ-ve rinore, në ngjarjet rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e rinisë, artit, trashëgimisë kulturore dhe sportit.
- Aktivitetet të cilat mund të mbështeten përmes këtij fondi janë pjesëmarrja dhe prezantimi i të rinjve dhe OJQ-ve në ngjarje ndërkombëtare duke përfshirë:
  - konferencat që organizohen për avancim të tematikave rinore dhe përfaqësim të zërit rinor;
  - aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare që mundësojnë dhe promovojnë vullnetarizmin dhe rolin e punës vullnetare;
  - aktivitetet tjera si garat ndërkombëtare, kampet rinore, festivalet, panairët, seminarët, garat e debatit, punëtoritë; etj.

Nëpërmjet kësaj thirrje publike, individët dhe OJQ-të mund të mbështeten për mbulimin e shpenzimeve sikurse: shpenzime të udhëtimit, shërbime të transportit, akomodimi, shpenzimi i vizave, regjistrimi për pjesëmarrje në platformat respektive, mëditje, pagesë (taksë), hapësirat e prezantimit (qiraja) dhe të ngjashme.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, vajzat e reja, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

**Vlerësimi i projekt-propozimeve** do të zhvillohet në dy faza:

**Vlerësimi administrativ**, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

**Vlerësimi përmbajtësor**, që vlerëson:

- Nëse aplikuesi është i moshës rinore (15 - 24 vjeç) dhe aktiv në fushën e rinisë;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt- propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt- propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

## **Aplikimi**

Aplikimi me projekt-propozime bëhet përmes e-mail-it: [mobiliteti.mkrs@rks-gov.net](mailto:mobiliteti.mkrs@rks-gov.net)

## **Dokumentet e nevojshme**

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

8. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit,
9. Formulari i Propozim buxhetit,
10. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
11. Formulari i deklaratës se partneritetit,
12. Forma e deklaratës se projekteve të financuara,
13. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal,
14. Dokumentacioni për bartësin e projektit dhe individët/profesionistët e angazhuar: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale;



### **Afati për aplikim:**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën **07 Prill 2023**.

### **Informata shtesë rreth aplikimit:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [burim.mexhuani@rks-gov.net](mailto:burim.mexhuani@rks-gov.net);

### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- Individët që kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, të profilizuar, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

### **Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2022;
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.



**Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara dhe me përvojë të dëshmuar në sektorin e rinisë, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Të ofrojnë ftesën zyrtare apo letrën e pranimit për pjesëmarrje në ngjarjen përkatëse.

**Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Individidi duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2022;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se një projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

**Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Profilet e përshtatshme të individëve për këtë thirrje janë të rinjtë, profesionistët e rinj, studentët, pjesëtarët e grupeve vullnetare, pjesëtarët e grupeve rinore kulturore e sportive etj.
- Të ofrojnë ftesën zyrtare apo letrën e pranimit për pjesëmarrje në ngjarjen përkatëse.

**Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese të mobilitetit në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2023.

**Shkalla e mbështetjes:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues N.A. Euro

## ART DHE TRASHËGIMI KULTURORE

### Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Kosovës

Në këtë kategori të thirrjes publike parashihet mbështetja e nismave individuale dhe grupe, për pjesëmarrje në aktivitete që do të kontribuojnë në promovimin ndërkombëtar të artit vendor dhe trashëgimisë kulturore. Aktivitetet të cilët përfshihen në këtë kategori janë pjesëmarrja, prezantimi dhe/apo performim i akterëve/individëve dhe OJQ-ve në ngjarje ndërkombëtare duke përfshirë konferenca, festivale, panaire, koncerte, ekspozita etj. në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet kësaj thirrjeje publike, mbështeten aktivitetet sikurse shpenzimet e udhëtimit, shërbime të transportit, akomodimi, mëditje, pagesë (taksë) regjistrimi për pjesëmarrje në platformat përkatëse, hapësirat e prezantimit (qiraja) dhe të ngjashme.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

**Vlerësimi i projekt-propozimeve** do të zhvillohet në dy faza:

**Vlerësimi administrativ**, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

**Vlerësimi përmbajtësor**, që vlerëson:

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;

- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

### **Aplikimi**

Aplikimi me projekt-propozime bëhet përmes e-mail-it: [mobiliteti.mkrs@rks-gov.net](mailto:mobiliteti.mkrs@rks-gov.net)

### **Dokumentet e nevojshme**

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

15. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit,
16. Formulari i Propozim buxhetit,
17. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
18. Formular i deklaratës se partneritetit,
19. Forma e deklaratës se projekteve të financuara,
20. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal,
21. Dokumentacioni për bartësin e projektit dhe individët/profesionistët e angazhuar: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale;

### **Afati për aplikim:**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën **07 Prill 2023**.

### **Informata shtesë rreth aplikimit:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [nita.lloncari@rks-gov.net](mailto:nita.lloncari@rks-gov.net); [merita.augustini@rks-gov.net](mailto:merita.augustini@rks-gov.net);

### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- Individët e regjistruar në Republikën e Kosovës, të profilizuar, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

### **Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2022;
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

### **Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Të ofrojnë ftesën zyrtare apo letrën e pranimit për pjesëmarrje në ngjarjen përkatëse.

**Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Individidi duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2022;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

**Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Profilet e përshtatshme të individëve për këtë kategori janë krijuesit artistik, performuesit artistik, profesionistët e trashëgimisë kulturore, studiues, hulumtues në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Të ofrojnë ftesën zyrtare apo letrën e pranimit për pjesëmarrje në ngjarjen përkatëse.

**Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2023.

**Shkalla e mbështetjes:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues N.A. Euro